



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

RAPORT

Mbi ecurinë e punës në IKP për vitin 2023

Institucioni i Komisionerëve Publikë është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 179/b dhe aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si organ i sistemit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, me qëllim garantimin dhe funksionimin e shtetit të së drejtës dhe pavarësisë në sistemin e drejtësisë, si edhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

Institucioni i Komisionerëve Publikë, si përfaqësues i interesit publik gjatë procesit të Reformës në Drejtësi, ushtron këto kompetenca kryesore:

- a. Ushtron ankim ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ankim i cili shqyrtohet nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese (neni 179/b/5 i Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2, neni F, pika 7 e aneksit të Kushtetutës dhe neni 63/1 i ligjit nr. 84/2016).
- b. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit u jep Komisionerëve Publikë rekomandime me shkrim, për të paraqitur ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, për vendimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim, duke dhënë arsyet e refuzimit (neni B, germa “c” e aneksit të Kushtetutës).
- c. Miraton rregulla për veprimtarinë e institucionit (neni 69/3 i ligjit nr. 84/2016).

Ky raport statistikor përmban të dhëna për veprimtarinë në tërësi të IKP-së, gjatë vitit 2023, si dhe gjatë gjithë periudhës së funksionimit të institucionit, shkurt 2018 - 2023.


I. STATISTIKË E PROCESIT

I.1 STATISTIKË PËRMBLEDHËSE PËR VITET 2018-2023

I.1.1 - Tabelë përmbledhëse për vitet 2018-2023


Periudha	Vendime të njoftuara nga KPK	Dispozitivi i vendimit të njoftuar			Rekomandime nga ONM	Ankime	Mosankime
		Konfirmim në detyrë	Shkarkim nga detyra	Ndërprerje procesi			
Viti 2018	77	33	29	15	5	16	61
Viti 2019	127	55	44	28	5	13	114
Viti 2020	103	35	38	30	3	16	87
Viti 2021	171	62	68	41	8	14	157
Viti 2022	109	50	36	23	2	11	98
Viti 2023	126	76	28	22	12	29	97
Totali	713	311	243	159	35	99	614

I.1.2 - Vendime të njoftuara 2018-2023




Grafiku nr. 1 – Vendime të njoftuara: 2018-2023

DISPOZITIVI I VENDIMEVE: 2018-2023



Grafiku nr. 2 - Vendime të njoftuara në IKP sipas dispozitivit, 2018-2023

I.1.3 - Rekomandime nga ONM, 2018-2023




Grafiku nr. 3 - Numri i rekomandimeve të ONM-së, sipas viteve

Sipas grafikut nr. 3, vihet re se në vitin 2023 është numri më i lartë i rekomandimeve (12), krahasuar me vitet e tjera të ushtrimit të aktivitetit të institucionit.


Në të gjitha rastet e rekomandimeve të ardhura në IKP, Institucioni i Komisionerëve Publikë ka ushtruar ankim kundër vendimeve të KPK-së.

I.1.4 - Shqyrtimi i vendimeve, rekomandimeve, denoncimeve nga publiku: 2018-2023




Grafiku nr. 4 – Ankime të ushtruara në vitet 2018-2023

Në grafikun nr. 4 pasqyrohen të dhënat mbi vendimmarrjen e Komisionerëve Publikë në shqyrtimin e vendimeve të njoftuara nga KPK, në vitet 2018, 2019, 2020, 2021, 2022, 2023.



Grafiku nr. 5 – Ankime dhe mosankime në vitet 2018-2023


SUBJEKTE RIVLERËSIMI: 2018-2023



Grafiku nr. 6 - Subjektet e rivlerësimit sipas funksioneve, në vite - 2018-2023

Në grafikun krahasimor dhe njëkohësisht përmblendhës, nr. 6, rezulton se numri i gjyqtarëve është më i lartë se i prokurorëve.


Ankimet sipas funksioneve të subjekteve të rivlerësimit: 2018-2023



Grafiku nr. 7 - Ankimet e Komisionerëve Publikë sipas funksioneve të subjekteve të rivlerësimit, në vitet 2018-2023

Ecuria e denoncimeve nga publiku të administruara në IKP gjatë 6 viteve: 2018-2023, është pasqyruar në grafikun e mëposhtëm nr. 8, ku rezulton se numri më i lartë i denoncimeve të administruara është në vitin 2019, me 361 të tilla, rrjedhimisht edhe numri i subjekteve të denoncuara është i madh, deri në 710 të tilla.

Numri i denoncimeve nga publiku në vite: 2018-2023




Grafiku nr. 8 - Denoncimet nga publiku, në vite, 2018-2019-2020-2021-2022-2023

I.1.5 - Seancat gjyqësore të zhvilluara në KPA, 2018-2023

Seancat e zhvilluara në vite, ku seanca e parë daton më 16 maj 2018 dhe e fundit më 15 dhjetor 2023, janë në total 347 të tilla. Në grafikun e mëposhtëm, nr. 9, tregohet numri i seancave të zhvilluara në vite dhe lidhja e tyre me numrin e subjekteve të shqyrtuara.

Pra, 347 seanca për 65 subjekte rivlerësimi të gjykuar.

Ecuria e seancave të zhvilluara në vite: 2018-2023




Grafiku nr. 9 - Numri i seancave në të cilat kanë marrë pjesë KP në vite, 2018-2023

I.2 - STATISTIKË PËRMBLEDHËSE PËR VITIN 2023

I.2.1 - Vendime të njoftuara nga KPK-ja – viti 2023

Institucioni i Komisionerëve Publikë, në referencë të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, deri në datën 31 dhjetor 2023, është njoftuar për 126 vendime nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

Ecuria e njoftimeve të tyre sipas muajve është pasqyruar në grafikun e mëposhtëm:




Grafiku nr. 10 - Numri i vendimeve të ardhura në IKP sipas muajve

Sa më sipër vërehet se muajt gusht-tetor-nëntor rezultojnë muajt me numrin më të vogël të vendimeve të ardhura në IKP (2/7/7 vendime) dhe muaji qershor me numrin më të madh të vendimeve të ardhura (17 vendime).

126 vendimet e njoftuara nga KPK, gjatë vitit 2023, kanë dispozitiv:


- 76 Konfirmime;
- 28 Shkarkime;
- 22 Të deklarojë se procesi është ndërprerë.

Të shprehura në përqindje, të dhënat e dispozitivëve janë pasqyruar në grafikun e mëposhtëm, nr. 11.



Grafiku nr. 11 - Vendime të njoftuara nga KPK - viti 2023, sipas dispozitivit në përqindje


Në grafikun nr. 12 paraqitet, në mënyrë më të përmblodhur, dispozitivi i vendimeve të ardhura nga KPK-ja, sipas muajve, për vitin 2023.



Grafiku nr. 12 - Dispozitivi i vendimeve të KPK-së, të ardhura në IPK sipas muajve, viti 2023

Subjektet e rivlerësimit, 126 subjekte në total, për të cilët janë njoftuar vendimet nga KPK-ja, janë të funksioneve të ndryshme. Në grafikun e mëposhtëm, nr.13, tregohet se numri i prokurorëve është më i lartë se ai i gjyqtarëve, 65 ndaj 54, dhe të funksioneve të tjera, 7 subjekte.

Subjekte të rivlerësimit sipas funksioneve - viti 2023




Grafiku nr. 13 - Subjektet e rivlerësimit sipas funksioneve, viti 2023

I.2.2 - Rekomandime nga ONM-ja – viti 2023

Referuar nenit 65/2, të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit B, pika c e aneksit të Kushtetutës, Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit (ONM) u jep Komisionerëve Publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit për vendimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim, duke dhënë arsyet e refuzimit (neni B, germa “c” e aneksit të Kushtetutës).

Për vitin 2023, në IKP kanë ardhur 12 rekomandime nga ONM-ja: 2 në shkurt/1 në mars/2 në prill/2 në maj 2 në qershor/ 1 në shtator/1 në tetor/1 në nëntor 2023 (shih grafikun nr.14).




Grafiku nr. 14 - Numri i rekomandimeve të ONM-së, të ardhura në IKP, sipas muajve, viti 2023

I.2.3 - Shqyrtimi i vendimeve nga Komisionerët Publikë – viti 2023

Për vendimet e njoftuara nga KPK gjatë vitit 2023, pas shqyrtimit të tyre, në zbatim të nenit 63, të ligjit nr. 84/2016, Komisionerët Publikë kanë ushtruar të drejtën e ankimit në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese, për 29 vendime të KPK-së. Për 97 vendime është njoftuar mosankim. Sqarojmë se, sipas afateve ligjore (15 ditë pas njoftimit, referuar nenit 63 të ligjit nr. 84/2016), shqyrtimi i 9 vendimeve të fundit të dhjetorit 2022 ka përfunduar në janar 2023, nga të cilat: 1- ankim dhe 8-mosankime.


Në grafikun nr.15 tregohet vendimmarrja e Komisionerëve Publikë për 126 vendimet e njoftuara në vitin 2023.



Grafiku nr. 15 - Vendimmarrje e Komisionerëve Publikë, viti 2023

Në grafikun nr.16 janë paraqitur ankimet dhe mosankimet për vitin 2023, sipas muajve të ushtrimit të tyre nga Komisionerët Publikë, ku muajt me numrin më të madh të ankimeve (5), janë muajt: shkurt, tetor, nëntor 2023.


Ankime e mosankime sipas muajve të ushtrimit të tyre - viti 2023



Grafiku nr. 16 - Vendimmarrje e Komisionerëve Publikë sipas muajve

Nëse analizojmë statusin e subjektit të rivlerësimit nën këndvështrimin e vendimmarrjes së Komisionerëve Publikë, për vitin 2023, sipas grafikut të mëposhtëm nr. 17, vihet re se numri i prokurorëve të ankimuar është më i lartë se ai i gjyqtarëve (19/7), ndërsa numri i mosankimeve është pothuajse i njëjtë (47/46).

ANKIME/MOSANKIME SIPAS FUNKSIONIT TË SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT - VITI 2023




Grafiku nr. 17 -Vendimmarrje e Komisionerëve Publikë sipas funksioneve të subjekteve të rivlerësimit

1.2.4 - Denoncimet nga publiku - viti 2023

Administrimi i denoncimeve nga publiku ushtrohet në zbatim të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Për këtë, në faqen zyrtare të IKP-së, “Formulari i Denoncimit nga Publiku” është vendosur në një menu të veçantë, të dukshme, si dhe


në tabelën e Programit të Transparencës. Formularët, të plotësuar dorazi nga vetë qytetarët dhe të dërguar në rrugë elektronike, administrohen nga Specialisti i Pritjes me popullin.



Grafiku nr. 18 - Denoncimet nga publiku, sipas muajve, viti 2023

Nëse i referohemi grafikut, shihet qartë *trendi* i denoncimeve të ardhura në IKP sipas muajve. Numri më i madh i denoncimeve është në muajin maj (24), dhe më i ulëti në muajt gusht – dhjetor, me 7 denoncime.


Nëse bëjmë një analizë të funksioneve të subjekteve të rivlerësimit, të cilët janë denoncuar nga publiku, në IKP, për vitin 2023, çka u referua në grafikun e mësipërm, rezulton se denoncimet janë kryesisht për prokurorë (111) dhe gjyqtarë (82), sikurse pasqyrohet në grafikun e mëposhtëm.



Grafiku nr. 19 - Denoncimet nga publiku, sipas subjekteve të rivlerësimit, viti 2023

I.2.5 - Pjesëmarrja në seancat e gjykimit të ankimit të IKP-së në KPA - viti 2023

Referuar neneve 5, pika 2, 63, pika 1, 65, pika 3, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në rastin e ankimit të vendimit të KPK-së, nga Komisioneri Publik, Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) e gjykon çështjen në seancë publike. Gjatë vitit 2023 janë zhvilluar 43 seanca për 12 subjekte rivlerësimi.



Grafiku nr. 20 – Seanca të zhvilluara në KPA gjatë vitit 2023


II - BUXHETI DHE MENAXHIMI I FONDEVE PUBLIKE

Buxheti i miratuar për Institucionin e Komisionerëve Publikë, për vitin 2023, është zbatuar bazuar në legjislacionin në fuqi, ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr.10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, ligjin nr. 162/2020, “Për prokurimin publik” dhe aktet nënligjore rregullatore, aktet nënligjore në fushën e zbatimit të buxhetit të shtetit, si dhe në drejtimit kryesore të miratuara me vendimet e Mbledhjes së Komisionerëve Publikë dhe Grupit të Menaxhimit Strategjik, dhe në parimin e ligjshmërisë, ekonomicitetit, efikasitetit dhe eficiencës në përdorimin e fondeve buxhetore.

Performanca e realizimit të fondeve buxhetore për këtë vit është në nivelin 98%, e cila paraqitet më poshtë, krahas realizimit të buxhetit ndër vite për Institucionin e Komisionerëve Publikë

Në mijë lekë

Emërtimi	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
Buxheti vjetor i rishikuar	50,155	74,262	67,050	70,350	76,835	131,400
Realizimi vjetor	46,423	69,519	63,387	67,776	76,666	128,746
Realizimi në %	92,6%	93,6%	94,5%	97,8%	99,8%	98%



Grafiku nr. 21 - Realizimi i buxhetit 2018-2023


Situata buxhetore për vitin 2023 paraqitet në vijim në formë tabelore dhe grafike.

Me ligjin nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, u miratua buxheti total vjetor për Institucionin e Komisionerëve Publikë, në vlerën 90,200 mijë lekë, i detajuar në 79,400 mijë lekë në shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore, 9,300 mijë lekë në shpenzime operative dhe 1,500 mijë lekë në shpenzime kapitale (investime). Gjithashtu, në zbatim të udhëzimit plotësues të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, nr. 2, datë 19.1.2023, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, është miratuar detajimi i fondit të veçantë për vitin 2023, në vlerën 200 mijë lekë.

Gjatë vitit 2023, ky buxhet është rishikuar në shpenzime korente, për shkak se legjislacioni në fushën e pagave ka pësuar ndryshime rrënjësore. Me akte ligjore dhe nënligjore dhe nëpërmjet rialokimeve brenda shpenzimeve korente, buxheti arriti në 131,400 mijë lekë, duke u rritur shpenzimet e personelit në 125,600 mijë lekë dhe pakësuar shpenzimet operative në 4,100 mijë lekë.

Në mijë lekë

Emërtimi	Buxheti vjetor	Buxheti vjetor i rishikuar	Realizimi vjetor	Realizimi në %
Shpenzime korente	88,900	129,900	128,746	99%
Shpenzime kapitale	1,500	1,500	-	-
TOTALI	90,400	131,400	128,746	98 %



Grafiku nr. 22 - Situata buxhetore në vitin 2023

Gjatë këtij viti janë kryer disa procedura prokurimi në zbatim të dispozitave ligjore në fushën e prokurimit publik dhe në përputhje me Regjistrin e Parashikimit të Procedurave të Prokurimit Publik, të miratuar në fillim të vitit, për furnizimin materialo-teknik të stafit të institucionit, administrimin e nevojave të institucionit dhe krijimin e kushteve optimale të punës. Theksojmë se ato janë kryer brenda fondeve buxhetore të miratuara për vitin 2023, në përputhje me dispozitat ligjore dhe në bazë të parimit të efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit.

- Projektbuxheti 2024-2026

Institucioni i Komisionerëve Publikë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, udhëzimit nr. 22, datë 7.7.2023, “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026”, dhe udhëzimit nr. 7, datë 28.2.2018, “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, ka përmbushur detyrimin ligjor për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për periudhën 2024-2026.

Kërkesat buxhetore për periudhën 2024-2026 janë hartuar duke respektuar rregullat dhe procedurat standarde të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm, por gjithashtu duke marrë në konsideratë përfundimin e mandatit kushtetues të institucionit, më 31.12.2024. Nga Ekipi i Menaxhimit të Programit dhe GMS-ja është konstatuar se tavanet përfundimtare të shpenzimeve buxhetore në shpenzime personeli nuk merrnin në konsideratë ndryshimet në legjislacionin e pagave, si për magjistratët, ashtu edhe për administratën. Për sa i përket shpenzimeve për blerje mallra dhe shërbime, tavanet buxhetore përputheshin me kërkesën e institucionit, ndërsa shpenzimet kapitale tejkalonin kërkesën e institucionit.

Në kërkesat buxhetore të institucionit, në shpenzime personeli për vitin 2024 janë përfshirë edhe efektet shtesë për shkak të rilogaritjes së pagës për Komisionerët Publikë dhe Këshilltarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor, prej fillimit të aktivitetit të institucionit, në vlerë 43,630 mijë lekë, në zbatim të vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 35/2022. Kjo kërkesë është parashtruar vazhdimisht gjatë vitit 2023, me shkresat zyrtare drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, duke detajuar buxhetin shtesë dhe numrin e përfituesve.

Meqenëse mandati kushtetues i Institucionit të Komisionerëve Publikë përfundon me 31.12.2024, sipas përcaktimeve në nenin 70, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, përveç rasteve kur autorizohet ndryshe nga Kuvendi, mandati i vetëm që vazhdon, është ai i Sekretarit të Përgjithshëm, i cili ka një personel të mjaftueshëm për të përmbushur detyrat. Në mungesë të akteve përkatëse rregullatore, është e vështirë të parashikohet me saktësi numri i stafit që do të vijojë punën për mbylljen e institucionit dhe, për këtë arsye, është përllogaritur një fond i përafërt në shpenzime korente, rreth 35 milionë lekë, për vitin 2025, ndërkohë që nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk janë parashikuar tavane buxhetore në shpenzime korente për këtë vit.

Me miratimin e ligjit të buxhetit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, u plotësuan kërkesat vjetore në shpenzime personeli për strukturën organike, duke reflektuar rritjen e pagave sipas akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe një fond shtesë për riklasifikimin e pagave të kësaj strukture.